

EDUKIM PËR TË GJITHË

Një studim mbi barrierat strukture
të studentëve LGBTI në arsimin shqiptar.

Publikuar nga:
Aleanca LGBTI



Autor: Blin Sali

Me mbështetje nga:



EDUKIM PËR TË GJITHË

(EUSA LGBTI)

Të Kuptojmë Vështirësitë e Studentëve LGBTI në Shqipëri

*Një studim mbi Barrierat Strukturore
të të Rinjve LGBTI në Sistemin Arsimor Shqiptar*

Informacion mbi publikimin:

Ky dokument është prodhuar me mbështetje financiare nga një projekt i përbashkët midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.

Tiranë 2026

Autor i Studimit: Blin Sali

Publikuar nga Aleanca LGBTI

© Aleanca LGBT



TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje - Qëllimi i Studimit.....	03	7. Analiza e Fokus Grupit.....	16
2. Mirënjohje.....	04	■ 7.1 Profili i Pjesëmarrësve....	16
3. Përmbledhje Ekzekutive.....	05	■ 7.2 Gjetjet Kryesore.....	17
4. Metodologjia e Studimit.....	06	■ 7.3 Konkluzione - Fokus Grup.....	19
5. Situata e Studentëve LGBTI në Shqipëri.....	09	8. Tema Kryesore të Identifikuara...	20
6. Analiza e të Dhënave nga Pyetësi.....	10	9. Rekomandime.....	21
■ 6.1 Profili i Pjesëmarrësve....	10	■ 9.1 Për Arsimin e Lartë.....	21
■ 6.2 Përvojat e Diskriminimit..	11	■ 9.2 Për Arsimin Parauniversitar	23
■ 6.3 Ndikimi dhe Mbështetja..	12	■ 9.3 Për Politikbërësit dhe për Institucionet Publike.....	24
■ 6.4 Intervistë Individuale.....	14	10. Përfundime.....	26
■ 6.5 Konkluzione nga Pyetësi.....	15	11. Referenca.....	28

1. Hyrje - Qëllimi i Studimit

Arsimi përfaqëson një mekanizëm themelor të zhvillimit individual, integritit social dhe mobilitetit ekonomik. Megjithatë, për qytetarët LGBTQI në Shqipëri, përvoja arsimore shpesh shoqërohet me diskriminim, bullizim, mungesë mbështetjeje institucionale dhe barrierë socio-ekonomike. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien psikologjike, si dhe në aksesin, vazhdimësinë dhe përfundimin e arsimit.

Ky studim analizon barrierat strukturore me të cilat përballen qytetarët LGBTQI në sistemin arsimor shqiptar, në nivel parauniversitar dhe universitar. Ai synon të identifikojë modelet e përjashtimit dhe boshllëqet institucionale që kontribuojnë në riprodhimin e pabarazive arsimore.

Në mënyrë më specifike, studimi synon:

- 1. Të dokumentojë përvojat e diskriminimit dhe përjashtimit në mjediset arsimore;**
 - 2. Të analizojë faktorët ekonomikë, socialë dhe institucionalë që ndikojnë në ndërprerjen ose mos-ndjekjen e arsimit të lartë;**
 - 3. Të vlerësojë nivelin e mbështetjes institucionale dhe efektivitetin e mekanizmave të raportimit;**
 - 4. Të evidentojë ndikimin psikologjik dhe social të përjashtimit arsimor;**
 - 5. Të ofrojë rekomandime konkrete për institucione arsimore dhe politikëbërës.**
-

Ky studim synon të kontribuojë në zhvillimin e politikave dhe praktikave arsimore më gjithëpërfshirëse, të bazuara në të drejtat e njeriut dhe të ndjeshme ndaj diversitetit.

2. Mirënjohje

Aleanca LGBTI shpreh mirënjohjen e saj të sinqertë për të gjithë studentët dhe qytetarët që ndanë përvojat e tyre në kuadër të këtij studimi. Pa gatishmërinë dhe besimin e tyre, ky raport nuk do të ishte i mundur. Falenderojmë gjithashtu ekspertët, aktivistët dhe bashkëpunëtorët që kontribuan me këshilla metodologjike dhe reflektime kritike gjatë hartimit të raportit.

Falenderojmë përzemërsisht mbështetësit tanë që mundësuan realizimin e këtij projekti:

[IGLYO](#) (Organizata Ndërkombëtare për të Rinjtë & Studentët LGBTQI) dhe [Këshilli i Europës](#) (Council of Europe).

Një falënderim i veçantë shkon për IGLYO për mbështetjen shtesë me konsultime dhe mentorim në kuadër të [Programit të Mentorimit për Edukimin Gjithëpërfshirës të LGBTQI](#) (Mentorship Programme for LGBTQI Inclusive Education), duke kontribuar kështu edhe në zhvillimin metodologjik dhe edukativ të projektit.

3. Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport analizon barrierat strukturore që përballen të rinjtë LGBTQI në Shqipëri gjatë trajektores së tyre arsimore. Studimi argumenton se **përrjashtimi arsimor** nuk është episodik, por **rezultat i ndërthurjes së faktorëve ekonomikë, socialë, institucionalë dhe psikologjikë**.

Gjetjet tregojnë se përrjashtimi shpesh fillon në **arsimin parauniversitar**, ku **bullizimi dhe mungesa e reagimit institucional** krijojnë braktisje të hershme. Në nivel universitar, klima e neutralitetit pasiv dhe mungesa e mekanizmave të besueshëm të raportimit kontribuojnë në mos-raportim dhe stres të vazhdueshëm.

Raporti përfundon me **rekomandime konkrete për universitetet dhe sistemin parauniversitar**, duke theksuar nevojën për politika aktive përfshirjeje dhe monitorim të vazhdueshëm.

4. Metodologjia e Studimit

Ky studim përdor një **qasje kualitative** të kombinuar me **desk research**, duke synuar të kapë **përvojat subjektive të individëve LGBTQI** në Shqipëri, si dhe **kontekstin institucional dhe krahasimet me literaturën ekzistuese**.

Qasja e kombinuar lejon një kuptim më të thelluar të barrierave strukturore që ndikojnë në aksesin dhe vijueshmërinë arsimore.

Grupet e synuara

Në fillim, studimi synonte dy grupe kryesore:

- **Qytetarë LGBTQI aktualisht të regjistruar në arsimin e lartë:** për të kuptuar sfidat dhe përvojat brenda universiteteve
- **Qytetarë LGBTQI që kishin ndërprerë arsimin e lartë:** për të eksploruar faktorët që kontribuojnë në braktisjen e studimeve.

Gjatë mbledhjes fillestare të të dhënave përmes pyetësorit anonim, u identifikua një grup i konsiderueshëm individësh që nuk kishin ndjekur kurrë arsimin e lartë, duke përfshirë persona që kishin arritur deri në ciklin 9-vjeçar, disa deri në gjimnaz, dhe disa që nuk kishin filluar asnjë cikël formal. Bazuar në këtë zbulim, qasja u adaptua: u organizua një fokus grup i dedikuar vetëm për këta individë, për të eksploruar barrierat që penguan fillimin e arsimit të lartë dhe për të evidentuar urgjencën e situatës për qytetarët LGBTQI në Shqipëri.

4.1 Mbledhja e të Dhënave dhe Qasja Analitike

Studimi u mbështet në tre mjete kryesore për mbledhjen e të dhënave:

1. **Pyetësor anonim online**
2. **Fokus grup i dedikuar**
3. **Intervistë e thelluar individuale**

1. Pyetësor anonim online

U përdor një pyetësor anonim online me 28 përgjigje të plota. Qëllimi i tij ishte mbledhja e informacionit mbi përvojat e pjesëmarrësve në arsimin parauniversitar dhe universitar. Anonimiteti u garantua për të krijuar një ambient të sigurt për pjesëmarrësit dhe për të inkurajuar përgjigje të sinqerta.

2. Fokus grup i dedikuar

U zhvillua një fokus grup me persona që nuk kanë ndjekur arsimin e lartë. Qëllimi ishte diskutimi i sfidave dhe barrierave që kanë ndikuar në mungesën e aksesit në arsimin e lartë. Fokus grupi përfshiu individë me nivele të ndryshme arsimore (përfundim cikli 9-vjeçar, gjimnaz, ose pa përfunduar asnjë cikël formal). Të dhënat u dokumentuan përmes shënimeve gjatë diskutimit.

3. Intervistë e thelluar individuale

U realizua një intervistë e thelluar me një person që kishte ndërprerë arsimin e lartë. Qëllimi i intervistës ishte të kuptohej më në thellësi përvoja individuale dhe faktorët që ndikuan në ndërprerjen e studimeve.

Desk research / Analizë e literaturës ekzistuese

Analiza e literaturës ekzistuese u mbështet kryesisht në **raportin e publikuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTIQ+ (2021)**, i cili përfshin studimin [“Bullizmi në Shkolla dhe Universitete”](#) me autore Merita Poni. Raporti analizon përvojat e **196 nxënësve dhe studentëve LGBTIQ+ lidhur me bullizmin, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin në mjediset arsimore gjatë vitit akademik 2020–2021**.

Përveç këtij raporti, në analizë u mor në konsideratë edhe konteksti i iniciativave të mëparshme për ndërgjegjësim në shkolla.

[Në vitin 2015, përfaqësues të organizatave LGBTIQ+ zhvilluan aktivitete informuese në disa gjimnaze, përfshirë shfaqjen e dokumentarit](#)

[“SkaNdal”](#), i cili trajtonte çështjen e bullizmit dhe diskriminimit ndaj qytetarëve LGBTIQ+. Aktivitetet synonin ndërgjegjësimin mbi bullizmin, një fenomen i raportuar gjerësisht në shkollat e mesme dhe promovimin e respektit për të drejtat e njeriut.

Megjithatë, këto iniciativa u shoqëruan me reagime të forta negative në media dhe rrjete sociale. Pas reagimeve publike, **Ministria e Arsimit deklaroi se nuk kishte dhënë autorizim zyrtar për zhvillimin e këtyre aktiviteteve në shkolla, duke krijuar një situatë paqartësie institucionale**.

Debati publik që pasoi tregoi nivelin e lartë të polarizimit shoqëror rreth trajtimit të çështjeve LGBTI në mjediset arsimore.

Ky kontekst është i rëndësishëm për studimin aktual, pasi ndihmon në kuptimin e barrierave strukturore dhe institucionale që shoqërojnë përpjekjet për ndërgjegjësim dhe mbrojtje nga diskriminimi në shkolla dhe universitete. Ndërkohë që bullizmi dhe gjuha e urrejtjes rezultojnë të përhapura sipas raportit të vitit 2021, reagimet ndaj nismave edukative tregojnë sfidat që has trajtimi i këtyre çështjeve në sistemin arsimor shqiptar.

Qasja Analitike

Analiza kualitative u fokusua në identifikimin e temave dhe modeleve të përsëritura në të dhënat nga pyetësi, fokus grupi dhe intervistat.

Kombinimi i të dhënave cilësore dhe desk research lejon një kuptim të integruar të përvojave individuale dhe sfidave institucionale.

Rezultatet interpretohen si indikative dhe eksploruese, duke evidentuar barrierat strukturore dhe nevojën për ndërhyrje të hershme dhe politike përfshirjeje.

4.2 Kufizimet dhe Reflektive Metodologjike

Ky studim ka karakter eksplorues dhe synon të identifikojë modele dhe barrierat strukturore, jo të prodhojë të dhëna statistikisht përfaqësuese në nivel kombëtar. Mostra është e kufizuar dhe gjetjet duhen interpretuar si indikative.

Për personat që kanë ndërprerë arsimin e lartë, analiza u mbështet në pyetësin online dhe në një intervistë të thelluar individuale. Numri i pjesëmarrësve në këtë kategori ishte i kufizuar, çka lidhet me vështirësinë për të identifikuar dhe angazhuar persona që janë shkëputur nga sistemi universitar dhe nga rrjete të strukturuar akademike. Ndryshe nga personat që nuk kanë arritur fare në arsimin e lartë, të cilët u identifikuan më lehtë përmes rrjeteve komunitare, individët që kanë ndërprerë universitetin rezultuan më pak të pranishëm në struktura të organizuara dhe shpesh ndodheshin në periudha tranzicioni profesional ose personal. Kjo diferencë sugjeron forma të ndryshme të shkëputjes nga sistemi arsimor dhe ndikoi drejtpërdrejt në nivelin e përfshirjes në studim.

Për më tepër, përvoja e ndërprerjes së studimeve mund të perceptohet si çështje personale dhe e ndjeshme, çka mund të ndikojë në gatishmërinë për t'u përfshirë në intervista të thelluara.

5. Situata e Studentëve LGBTI në Shqipëri

Bazuar në studimin “Situata e studentëve LGBTI në Shqipëri: Raporti i vitit akademik 2020-2021” nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTIQ+, të rinjtë LGBTIQ+ përballen me nivele të larta bullizimi dhe diskriminimi në shkolla dhe universitete. Studimi u krye përmes një pyetsori online dhe u fokusua te përvojat negative të nxënësve dhe studentëve, si ngacmimet, komentet fyese dhe sulmet (Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTIQ+, 2021).

Pikat kryesore të raportit:

96% e pjesëmarrësve raportuan bullizëm kibernetik, dhe rreth 70% thanë se kanë qenë viktime e tij për arsye të ndryshme.

Pjesa më e madhe ndihen të pasigurt në tualete (41%), dhoma zhveshjeje (33%) dhe fusha sportive/palestre (16–17%).

Vetëm 11% raportuan ndërhyrje efektive nga stafi pedagogjik; shumica heshtin për shkak të frikës ose mungesës së besimit.

Tekstet shkollore dhe mjediset arsimore nuk përfshijnë informacion mbi komunitetin LGBTIQ+ (86–87% e studentëve raportojnë mungesë të tillë).

Trajnime për stafin dhe struktura institucionale për barazi mungojnë, duke lejuar normalizimin e komenteve dhe praktikave diskriminuese.

Ky studim tregon se studentët LGBTIQ+ përballen me sfida të konsiderueshme për të ndjerë siguri, mbështetje dhe përfaqësim në mjediset arsimore.

Referencë:

[Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTIQ+. \(2021\). Situata e studentëve LGBTI në Shqipëri: Raporti i vitit akademik 2020-2021.](#)

6. Analiza e të Dhënave nga Pyetësi për Studentët dhe Ish-Studentët LGBTQI


6.1 Profili i Pjesëmarrësve

Totali: 28 pjesëmarrës


Studentë aktualë



Ish-studentë



Pa arsim të lartë




Niveli i studimit

Master



Bachelor



Program i integruar



Fushat e studimit

STEM



Shëndetësi/Mjekësi



Shk. Sociale & Humane



Arte



Lloji i institucionit


Institucione Private



Institucione Publike



Seksualiteti/Identiteti gjinor



6.2 Përvojat e Diskriminimit dhe Raportimi

Raportimi i incidenteve:

86% e incidenteve të diskriminimit nuk u raportuan, kryesisht për shkak të frikës nga zbulimi i identitetit seksual/gjinor, mungesës së besimit se do të ndihmonte, ose pasojave negative të mëparshme.

Përvojat më të shpeshta:

Tallje, fyerje verbale, mosrespektim i emrit/gjinisë, ngacmime nga bashkëmoshatarët dhe stafi, përfshirë komentet homofobe/transfobe në mësim.

Citimet nga pyetësi tregojnë përvojën personale të studentëve:


"I kam përfunduar studimet Bachelor, por me shumë vështirësi dhe vendosa të mos i vazhdoj më tej për arsye që lidhen me sistemin e përgjithshëm jo të aksesueshëm në Shqipëri... Shpesh kam dëgjuar komente diskriminuese për persona që perceptohen si LGBT. Disa pedagoge bënë komente të papërshtatshme për artistë të njohur LGBT gjatë lëndëve të tyre, duke shoqëruar ato komente me të qeshura nga studenti."

"Mendësia e prapambetur me tone fyese ndaj komunitetit është shumë e evidente... shumica e individëve nuk kanë mundësi të shprehin identitetin e tyre haptazi... shpesh has shaka apo komente derogative të cilat përkrahen nga shumica e nxënësve. Injorimi i stafit akademik është i papranueshëm."

6.3 Ndikimi dhe Mbështetja

STUDENTËT QË KANË NDËRPRERË STUDIMET

Arsyet kryesore të ndërprerjes



Ndikimi psikologjik: Stres, depresion, shmangie e mësimeve, largim nga universiteti.

Citimet e studentëve theksojnë mungesën e mbështetjes institucionale:

“E para të kishim një psikologe... të mos kishte komente diskriminuese për personat LGBT... më humbi besimin komplet në institucion.”

STUDENTËT AKTUALË

- Vetëm **50%** raportojnë respekt të emrit/gjinisë nga stafi.
- Banjo/konviktet gjithëpërfshirëse dhe **politika kundër diskriminimit** shpesh **mungojnë** ose nuk janë të qarta.
- Trajnimet për **përfshirjen e studentëve LGBTQI** janë pothuajse **të padukshme** (**86.4%** nuk kanë patur mundësi).

Citimet e tyre tregojnë nevojën për përfshirje dhe mbështetje:

“Pedagogët të mos përdorin gjuhë homofobe... më shumë hapësira për studentët queer që të njohin njëri-tjetrin pa frikën e paragjykitimit... projekte për komunitetin LGBT... mjedis me tolerant.”

“Ndryshimet në institucione si universiteti janë të pavlera dhe thjesht performative për sa kohë që personat trans nuk kanë akses tek dinjiteti i ekzistencës ligjore dhe ndihma mjekësore e nevojshme.”

Ngacmimi dhe dhuna

Shpesh të përjetuara: fyerje verbale, tallje në klasë, mosrespektim i gjinisë/emrit, përjashtim nga grupet.

Vendet më të zakonshme: në klasë, ambiente të përbashkëta, jashtë universitetit, aktivitete studentore.

Raportimi i incidenteve: vetëm 13.6% e studentëve aktualë i raportuan incidentet; shumica nuk raportuan nga frika, për shkak të besimit se nuk do të ndihmonte, ose sepse nuk dinin si të raportonin.

Mbështetja institucionale

- **Njohja e shërbimeve:** shumë studentë nuk njohin psikologun e universitetit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), ose OJQ-të mbështetëse.
- **77.3% e studentëve e konsiderojnë universitetin aspak të përgatitur për studentët LGBTQI.**
- Trajnime për përfshirjen e studentëve LGBTQI janë pothuajse të padukshme (86.4% nuk i kanë parë).

Ndikimi në mirëqenie dhe arritje akademike

- **Për studentët që kanë ndërprerë studimet:** stres, ankth, depresion, shmangie e mësimëve, nota të ulëta, largim nga universiteti.
- **Për studentët aktualë:** ndjenja e ankthit dhe stresit shpesh për shkak

të klimës dhe ngacmimeve.

- **Mbështetja nga stafi/studentët është e kufizuar;** shumë kanë menduar të ndërpresin studimet.

6.4 Intervistë individuale

Intervistë me Student që Ndërpreu Arsimin e Lartë

Në kuadër të pyetësorit, u intervistua një qytetar me gjini jo-binare, 29-vjeç, i cili ndërpreu studimet në një program të integruar 5-vjeçar. Intervista u fokusua në përvojën e qytetarit në universitet dhe faktorët që ndikuan në vendimin për të ndërprerë studimet.

Pyetjet dhe përgjigjet:

1. Në çfarë faze ndërpreve studimet universitare?

‘Viti i pestë, program i integruar 5-vjeçar.’

2. Cilët ishin faktorët kryesorë që ndikuan në vendimin tënd për të ndërprerë universitetin?

‘Burnout akademik dhe lodhje e madhe nga kërkesat akademike.’

3. A ndikoi eksperiencia jote si person LGBTQI në këtë vendim? Nëse po, si?

‘Mendoj ndikoi më shumë të qenurit neurodivergjent sesa të qenurit queer. Ndonjëherë lidhen bashkë, sepse pasi ndryshova shprehinë gjinore, nuk u riktheva më në ambientin e universitetit. Përvoja LGBTI nuk ishte shkaku kryesor, por ndikoi indirekt në ndonjë rast.’

4. Si do ta përshkruaje ambientin e përgjithshëm në universitet për studentët LGBTQI?

‘Universitetet me drejtim më artistik janë pak më të hapur ndaj personave queer, qoftë në stil apo mënyrën e jetesës. Gjatë kohës kur isha duke ndjekur studimet, nuk ka pasur përkrahje të hapur për komunitetin, por as nuk kam hasur sjellje armiqësore haptazi.’

5. A pati momente kur u ndjeve pa mbështetje, i/e përjashtuar, ose në rrezik brenda universitetit?

‘Jo domosdoshmërisht lidhur me të qenurit queer. Atë periudhë nuk isha “out” dhe nuk lidhesha aktivisht me komunitetin, prandaj nuk ndjeva rrezik direkt.’

6. Çfarë lloj mbështetjeje mendon se do të të kishte ndihmuar të vazhdosh studimet?

‘Mbështetje institucionale më herët, njohja e mundësive për ndihmë psikologjike, dhe një ambient akademik më fleksibël që të mos kërkonte përsëritje të lëndëve kur ndërrohen programet.’

Pjesëmarrësi tregon se tentoi të rikthehej në universitet në vitin pasardhës, por ndryshimet në program e detyruan të përsërisë shumë lëndë, gjë që e bëri rikthimin të papërshtatshëm dhe jo të vlefshëm.

6.5 Konkluzione nga Pyetëtori dhe Intervista Individuale

Politikat ekzistuese në institucionet e arsimit të lartë janë shpesh të paplota ose joefektive:

- 40.9% e studentëve raportojnë një politikë të qartë kundër bullizmit,
- 40.9% raportojnë politikë kundër diskriminimit përfshirë SOGIESC,
- 22.7% raportojnë ekzistencën e një mekanizmi raportimi konfidencial.

Ndërkohë, të dhënat e pyetësit dhe intervista e thelluar me një student që ndërpreu studimet tregojnë se sfidat për studentët LGBTQI përfshijnë:

- Ambient jo gjithëpërfshirës dhe mungesë mbështetjeje institucionale: tallje, fyerje verbale, mosrespektim të emrit/gjinisë, dhe përjashtim nga grupet; mungesë e mbështetjes psikologjike dhe e politikave gjithëpërfshirëse.
- Barrierat akademike dhe strukturore: ndryshimet në program dhe lëndë e bëjnë rikthimin në universitet të vështirë ose jo të vlefshëm, duke

ndikuar në vendimin për ndërprerje të studimeve.

- Ndikimi psikologjik: stres, ankth, depresion dhe shmangie e mësimeve, si dhe ndjenja e pasigurisë për studentët aktualë. Përvoja LGBTI mund të ndikojë indirekt, sidomos kur lidhet me faktorë të tjerë si neurodivergjenca.
- Nevoja për përfshirje dhe mbështetje: studentët kërkojnë përfshirje më të madhe të çështjeve LGBTQI në kurrikul, trajnime dhe ndërgjegjësim për staf dhe studentë, mjedise miqësore dhe mbështetje psikologjike, si dhe implementim efektiv të mekanizmave të raportimit dhe politikave gjithëpërfshirëse.

Ky kombinim sugjeron se ndërhyrjet sistematike janë të domosdoshme për të krijuar një ambient akademik më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për

7. Analiza e të Dhënave nga Fokus Grupi

Tema: Barrierat për qytetarët LGBTQI që nuk kanë nisur arsimin e lartë

Numri i pjesëmarrësve: 6

Burimet e të dhënave: Foto, listë prezence, shënime të fasilitatorit

Metodologjia: Shënimet janë rindërtuar në mënyrë anonime. Kontributet janë përmbledhur mbi bazën e vëzhgimeve dhe dokumentacionit të disponueshëm, duke ruajtur konfidencialitetin e pjesëmarrësve.

7.1 Profili i Pjesëmarrësve

Gjinia dhe orientimi seksual

- 2 pjesëmarrës janë djem gay
- 1 pjesëmarrës me gjini jo-binare
- 1 pjesëmarrës biseksual
- 2 pjesëmarrëse gra trans

Niveli i arsimimit

- 2 pjesëmarrës kanë përfunduar shkollën e mesme
- 3 pjesëmarrës e kanë braktisur shkollën e mesme për shkak të bullizmit dhe presioneve sociale
- 1 pjesëmarrës ka përfunduar vetëm dy klasat e para të shkollës fillore

Mbështetja jashtë sistemit formal arsimor

Disa nga pjesëmarrësit kanë ndjekur kurse profesionale të ofruara nga Aleanca pas largimit nga shkolla. Këto kurse kanë kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike dhe në rritjen e motivimit për integrim në tregun e punës, por nuk kanë zëvendësuar mungesën e arsimit formal.

7.2 Gjetjet Kryesore

Analiza e diskutimeve identifikon disa kategori ndërthurëse pengesash që kanë ndikuar në mos-ndjekjen e arsimit të lartë.

a) FAKTORËT QË NDIKUAN NË MOS-NDJEKJEN E ARSIMIT TË LARTË

1. Barrierat financiare dhe mungesa e mbështetjes familjare

Kufizimet ekonomike për regjistrim, jetesë dhe mbulim shpenzimesh bazë janë ndër arsyet kryesore që kanë penguar pjesëmarrësit të vazhdojnë studimet. Në disa raste, mungesa e mbështetjes familjare e ka thelluar pasigurinë financiare dhe sociale.

2. Bullizimi dhe përjashtimi në shkollë

Pjesëmarrësit raportojnë përvoja të vazhdueshme talljeje, komentesh fyese, paragjykimesh për pamjen, veshjen ose shprehjen gjinore. Në disa raste është raportuar edhe dhunë fizike. Mungesa e reagimit nga stafi arsimor ka përforcuar ndjesinë e braktisjes institucionale.

Citime:

“Nxënësit e tjerë më bënin komente fyese dhe më tallnin aq shumë, sa që në një moment thashë me vete ‘jo, nuk mundem më.’”

“Thjesht doja të vishesha si më pëlqente, me fustan, por nuk më linin rehat. Më shanin gjithë kohën dhe madje kanë përdorur edhe dhunë fizike. Stafi nuk ka bërë asgjë, nuk kishte mbështetje për mua, kështu që vendosa të largohem.”

Këto përvoja tregojnë jo vetëm presion social, por edhe mungesë të mekanizmave efektivë mbrojtës brenda institucioneve arsimore.

3. Mungesa e informacionit dhe orientimit

Pjesëmarrësit shprehin ndjenjë shkëputjeje nga mundësitë e arsimit të lartë. Mungesa e informacionit, e mentorimit dhe e orientimit profesional ka reduktuar perceptimin e tyre për alternativa reale zhvillimi.

b) PENGESAT AKTUALE PËR VAZHDIMIN E STUDIMEVE

Përveç faktorëve që çuan në ndërprerje, pjesëmarrësit identifikojnë barrierë që vazhdojnë t'i mbajnë jashtë sistemit arsimor:

1. Pasiguria ekonomike

Mungesa e burimeve të qëndrueshme financiare vazhdon të jetë pengesë për rikthim në arsim.

2. Diskriminimi dhe presioni social i vazhdueshëm

Përrjashtimi nga familja, paragjykimet shoqërore dhe vështirësitë në punësim e përforcojnë ciklin e marginalizimit.

3. Ndikimi psikologjik dhe perceptimi i pashpresshmërisë

Ndjenja e inferioritetit, e pashpresës dhe vetë-fajësimit është e pranishme në rrëfimet e pjesëmarrësve.

Citime:

“Shokët e mi vazhduan shkollën normal, dhe unë ndihesha si të mos kisha asnjë shans. Frustrohesha dhe ndonjëherë fajësoja veten, edhe pse ishte plotësisht jashtë kontrollit tim.”

“Unë nuk di të shkruaj e të lexoj... nuk pata mundësi të shkoja në shkollë si fëmijë, prandaj tani gjërat e tjera për të ardhmen më duken të paarritshme.”

7.3 Konkluzione nga Gjetjet e Fokus Grupit

Gjetjet tregojnë se mos-ndjekja e arsimit të lartë nga qytetarët LGBTQI nuk është rezultat i zgjedhjeve individuale, por pasojë e një ndërthurjeje faktorësh strukturorë: diskriminimi sistematik, mungesa e mbështetjes familjare, përrjashtimi institucional dhe kufizimet ekonomike.

Përrjashtimi i hershëm nga sistemi arsimor krijon një efekt zinxhir që ndikon në:

- kufizimin e mundësive për punësim të qëndrueshëm;
- rritjen e rrezikut për varfëri;
- përfshirjen në forma të pasigurta ose informale pune;
- përkeqësimin e mirëqenies psikologjike;

- dobësimin e pjesëmarrjes sociale dhe qytetare.

Në këtë kuadër, pengesat e identifikuara kërkojnë ndërhyrje të koordinuara nga sistemi arsimor, politikat shtetërore të mbështetjes sociale dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim krijimin e mundësive reale për edukim, zhvillim personal dhe integrim profesional për qytetarët LGBTQI.

8. Temat Kryesore të Identifikuara

- **Barrierat financiare dhe mungesa e mbështetjes familjare** janë pengesa kryesore për të rinjtë LGBTQI. Pjesëmarrës që janë përballur me braktisje nga familja ose mungesë të mjeteve financiare shpesh kanë qenë të detyruar të ndalojnë shkollimin ose të kërkojnë mënyra ekstreme për të siguruar jetesën, duke përfshirë punën në aktivitete të rrezikshme. Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta për të ardhmen e tyre, duke kufizuar mundësitë për arsimin e lartë dhe integrimin në tregun formal të punës.
- **Bullizimi, diskriminimi dhe presionet sociale** ndalojnë vazhdimin e shkollimit dhe krijojnë ndjenja inferioriteti, izolimi dhe demotivimi. Pjesëmarrës raportuan përjashtim nga bashkëmoshatarët, tallje për veshjen ose sjelljen dhe mungesë mbështetje nga stafi akademik. Këto pengesa sociale ndikojnë në vetëbesimin dhe aftësinë për të kërkuar mundësi të reja, duke e bërë të vështirë pjesëmarrjen e plotë në shoqëri.
- **Mungesa e informacionit dhe mbështetjes strukturore** pengon ndjekjen e arsimit të lartë dhe kufizon aksesin në tregun e punës. Edhe ata që kanë përfunduar arsimin bazik ndihen të izoluar nga burimet dhe rrjetet që mund të siguronin informacione për mundësitë e studimeve ose punës. Për qytetarët që nuk kanë arsim të plotë, si një pjesëmarrëse që nuk di të shkruajë e lexojë, këto pengesa bëhen pothuajse të pakapërcyeshme, duke krijuar një cikël të pabarazisë dhe varfërisë.

- **Mundësitë e punësimit janë të kufizuara;** qytetarët LGBTQI shpesh refuzohen pa arsye dhe përballen me diskriminim të drejtpërdrejtë në intervista ose vendet e punës. Edhe kur ekzistojnë trajnime praktike, mungon një rrjet institucional mbështetës që të sigurojë integrim të qëndrueshëm në tregun e punës.
- **Kurset profesionale dhe mentorimi,** si ato të Aleancës, ofrojnë shembuj efektivë që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe motivimin personal. Megjithatë, mbështetja duhet të institucionalizohet dhe të jetë e vazhdueshme, me përgjegjësi të shtetit, në mënyrë që të sigurohet akses i barabartë për të gjithë qytetarët LGBTQI.
- **Nevoja për ndërhyrje profesionale në shkolla** është e qartë: kurrikulat, metodat e mësimdhënies dhe trajnim i stafit duhet të adresojnë bullizmin dhe diskriminimin ndaj personave LGBTQI. Një ndërhyrje e tillë mund të ulë ndjeshëm ndjenjat e inferioritetit, izolimit dhe pasigurisë, duke rritur shanset për vazhdim të arsimit dhe mirëqenie psikologjike.
- **Psikologët në shkolla duhet të jenë të informuar mbi situatën e studentëve LGBTQI** dhe të ofrojnë një mjedis të sigurt, konfidencial dhe pa gjykime. Mbështetja psikologjike mund të ndihmojë qytetarët LGBTQI të rikuperojnë vetëbesimin, të zhvillojnë aftësi për menaxhimin e presionit social dhe të ndihmojnë në planifikimin e një të ardhme më të qëndrueshme.

9. Rekomandime

9.1 Për Institucionet e Arsimit të Lartë

1. Reformim institucional dhe struktura të dedikuara për barazi

- Krijimi i Zyrave për Barazi, Diversitet dhe Përfshirje me mandat të qartë për trajtimin e çështjeve LGBTQI.
- Emërimi i një personi përgjegjës (Equality Officer) me trajnim specifik

mbi SOGIESC (Orientimi Seksual, Identiteti dhe Shprehia Gjinore dhe Karakteristikat e Lidhura me Seksin)

(Bazuar në: 77.3% e studentëve e konsiderojnë universitetin aspak të përgatitur; 86% incidente të pa-raportuara.)

2. Mekanizma raportimi realisht funksionalë

- Krijimi i sistemeve konfidenciale dhe të pavarura raportimi (online dhe fizik).
- Garanci kundër viktimizimit dytësor.
- Procedura të qarta disiplinore për raste diskriminimi nga stafi ose studentët.
- Publikim transparent i statistikave vjetore të rasteve (pa identifikim personal).

(Bazuar në: vetëm 13.6% raportim; frikë dhe mungesë besimi.)

3. Reformim i kurrikulës dhe përfshirje akademike

- Integrim i perspektivave LGBTQI në lëndët e shkencave sociale, juridike, mjekësore dhe humane.
- Rishikim i përmbajtjeve diskriminuese ose të vjetëruara.
- Mbështetje për kërkime akademike mbi çështjet LGBTQI.

(Bazuar në: 86–87% raportojnë mungesë përfaqësimi në tekste.)

4. Trajnime të detyrueshme për stafin akademik dhe administrativ

- Trajnime periodike mbi diskriminimin, bullizimin dhe përdorimin e gjuhës gjithëpërfshirëse.
- Trajnime specifike për respektimin e emrit dhe identitetit gjinor.
- Integrim i këtyre moduleve në zhvillimin profesional të pedagogëve.

(Bazuar në citimet për komente homofobe nga pedagogët.)

5. Mbështetje psikologjike e specializuar

- Psikologë të trajnuar mbi sfidat e qytetarëve LGBTQI.
- Garanci për konfidencialitet absolut.
- Programe për menaxhimin e stresit, ankthit dhe përballimin e traumës së bullizimit.

(Bazuar në: stres, depresion, largim nga studimet.)

6. Mbështetje ekonomike dhe akses në studime

- Bursë specifike për studentët LGBTQI në situata vulnerabiliteti (sidomos ata të përjashtuar nga familja).
- Fond emergjent për raste krize.
- Konvikte dhe ambiente të sigurta dhe gjithëpërfshirëse.

(Bazuar në: 66.7% ndërprerje për arsye financiare.)

9.2 Për Arsimin Parauniversitar

1. Protokolle të detyrueshme anti-bullizëm

- Hartim dhe zbatim i protokolleve kombëtare specifike për bullizimin me bazë SOGIESC.
- Procedura të qarta reagimi brenda 24–48 orësh.
- Përfshirje e prindërve dhe psikologëve në ndërhyrje.

(Bazuar në: braktisje të hershme për shkak të bullizimit.)

2. Reformë e kurrikulës dhe edukim për diversitet

- Integrim i temave mbi të drejtat e njeriut, diversitetin dhe respektin në lëndët ekzistuese.
- Materiale edukative të aprovuara institucionalisht për të shmangur paqartësitë si në rastin e 2015.
- Edukim mbi barazinë që në ciklin 9-vjeçar.

3. Trajnim i detyrueshëm për mësuesit dhe drejtuesit

- Trajnime për identifikimin dhe adresimin e bullizimit.
- Udhëzime për përdorimin e gjuhës neutrale dhe respektuese.
- Vlerësim periodik i performancës së stafit lidhur me trajtimin e diskriminimit.

4. Mbështetje psikologjike në shkolla

- Psikologë të trajnuar për të punuar me nxënës LGBTQI.
- Hapësira të sigurta brenda shkollës.
- Mekanizma për mbrojtjen e nxënësve që përballen me presion familjar dhe izolim.

(Bazuar në përjashtimin nga familja dhe efektin zinxhir.)

9.3 Për Politikëbërësit dhe Institucionet Publike

1. Strategji Kombëtare për Përfshirjen Arsimore të Qytetarëve LGBTQI

- Hartim i një plani kombëtar ndërsektorial (arsim, punësim, mbrojtje sociale).

- Monitorim i zbatimit përmes indikatorëve të matshëm.

2. Mbështetje sociale për persona të përjashtuar nga familja

- Skema strehimi të përkohshme.
- Ndihmë ekonomike dhe akses në arsim alternativ.
- Programe rikthimi në arsim për persona që kanë braktisur shkollën.

(Bazuar në fokus grup: persona pa arsim bazik.)

3. Formalizim dhe institucionalizim i mentorimit dhe kurseve profesionale

- Partneritet shtet–universitet–OJQ për programe mentorimi.
- Certifikim zyrtar i kurseve profesionale.
- Lidhje direkte me tregun e punës.

4. Fushata kombëtare ndërgjegjësimi

- Fushata publike kundër bullizimit dhe gjuhës së urrejtjes.
- Përfshirje e mediave për të reduktuar stigmatizimin.
- Promovim i historive pozitive të përfshirjes.

10. Përfundime

Ky studim konfirmon se përjashtimi arsimor i qytetarëve LGBTQI në Shqipëri nuk është një fenomen sporadik apo individual, por rezultat i një ndërthurjeje faktorësh strukturorë që veprojnë në mënyrë të vazhdueshme përgjatë trajektores arsimore. Nga arsimi parauniversitar deri në universitet, barrierat financiare, diskriminimi, mungesa e mbështetjes familjare dhe boshllëqet institucionale krijojnë një mjedis ku aksesimi dhe përfundimi i arsimit bëhet i pasigurt ose i pamundur për shumë individë.

Të dhënat nga pyetësi tregojnë një klimë universitare të perceptuar si të papërgatitur dhe jo gjithëpërfshirëse, me nivele të larta mos-raportimi të incidenteve për shkak të frikës, mungesës së besimit dhe mekanizmave joefektivë. Mungesa e trajnimeve për stafin, e përfaqësimit në kurrikul dhe e strukturave të qarta për barazi kontribuon në normalizimin e komenteve diskriminuese dhe në krijimin e një “neutraliteti pasiv” institucional që nuk ofron mbrojtje reale.

Gjetjet nga fokus grupi thellojnë këtë panoramë duke treguar se për shumë qytetarë LGBTQI përjashtimi ndodh në faza të hershme të arsimit. Bullizimi i vazhdueshëm, dhuna verbale apo fizike, presioni për të fshehur identitetin dhe izolimi familjar çojnë në braktisje të hershme të shkollës. Për individët që nuk kanë arritur as në arsimin e mesëm ose që nuk kanë ndjekur kurrë arsimin e lartë, përjashtimi arsimor shndërrohet në përjashtim social dhe ekonomik afatgjatë.

Studimi evidenton gjithashtu një efekt zinxhir: mungesa e arsimit kufizon aksesin në tregun formal të punës, rrit rrezikun e varfërisë dhe ekspozon individët ndaj formave të pasigurta të punësimit, ndërkohë që përkeqëson mirëqenien psikologjike dhe ndjenjën e përjashtimit qytetar. Përjashtimi arsimor, në këtë kuptim, nuk është vetëm çështje e të drejtës për arsim, por edhe e dinjitetit, barazisë dhe pjesëmarrjes së plotë në shoqëri.

Raporti tregon se ndërhyrjet sporadike ose simbolike nuk janë të mjaftueshme. Nevojiten reforma të strukturuar, mekanizma funksionalë raportimi, trajnime të detyrueshme, mbështetje psikologjike e specializuar

dhe politika sociale që adresojnë vulnerabilitetin ekonomik dhe përjashtimin familjar. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar ndërmjet institucioneve arsimore, politikëbërësve dhe organizatave të shoqërisë civile mund të ndërpritet cikli i riprodhimit të pabarazive. Në përfundim, garantimi i arsimit për qytetarët LGBTQI nuk është një çështje e veçantë sektoriale, por pjesë integrale e përmbushjes së parimit të arsimit për të gjithë. Siguria, përfaqësimi dhe mbështetja institucionale duhet të jenë standard, jo përjashtim. Ky studim synon të shërbejë si bazë për politika më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt barazisë reale në sistemin arsimor shqiptar.

11. Referenca

- [Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTIQ+. \(2021\). Situata e studentëve LGBTI në Shqipëri: Raporti i vitit akademik 2020–2021.](#)
- [IGLYO. \(2025\). Mentorship Programme for LGBTQI Inclusive Education.](#)
- [Pyetësori: ‘Përvojat e Studentëve dhe ish-Studentëve LGBTQI në Shqipëri](#)
- [IGLYO’s LGBTQI Inclusive Education Database](#)





www.aleancalegbt.org
aleanca.al@gmail.com
Tiranë, Shqipëri 2026